REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr.Br. 1115 - 1160/20
Datë/Datum. 10.02.21
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.1115/20
1160/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenkovic - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik "PBC" SH.P.K-Prishtinë dhe OE N.T.SH "Unisoft" Arianit Bytyqi B.I-Prishtinë, kundër njoftimit për anulim dhe refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-se, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Krijimi i bazës qendrore se te dhënave për regjistrimin personave te zhvendosur dhe të kthyerve", me nr. të prok. 211-20-6152-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ "Ministria për Komunitet dhe Kthim", më datën: 08.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHET</u>, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "PBC" SH.P.K-Prishtinë, kundër njoftimit për anulim dhe refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-se, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Krijimi i bazës qendrore së të dhënave për regjistrimin personave te zhvendosur dhe të kthyerve", me nr. të prok: 211-20-6152-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria për Komunitet dhe Kthim".

II. <u>APROVOHET</u>, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik N.T.SH "Unisoft" Arianit Bytyqi B.I-Prishtinë, kundër njoftimit për anulim dhe refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Krijimi i bazës qendrore së të dhënave për regjistrimin personave te zhvendosur dhe të kthyerve", me nr. të prok: 211-20-6152-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria për Komunitet dhe Kthim".

III. <u>ANULOHET</u>, njoftimi për anulim i Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull "Krijimi i bazës qendrore së të dhënave për regjistrimin personave të zhvendosur dhe të kthyerve", me nr. të prok: 211-20-6152-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria për Komunitet dhe Kthim", dhe lënda të kthehet në **rivlerësim.**

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues "PBC" SH.P.K-Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, si dhe ankesa e OE N.T.SH "Unisoft" Arianit Bytyqi B.I-Prishtinë, aprovohet si e bazuar, të njëjtëve iu bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatorët ekonomik ankues "PBC" SH.P.K-Prishtinë, si dhe OE N.T.SH "Unisoft" Arianit Bytyqi B.I-Prishtinë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 18.12.2020 me nr. 1115/20 dhe me 28.12.2020 me nr. 1160/20, kundër njoftimit për anulim dhe refuzim të kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Krijimi i bazës qendrore së të dhënave për regjistrimin personave të zhvendosur dhe të kthyerve", me nr. të prok: 211-20-6152-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/- "Ministria për Komunitet dhe Kthim", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, si dhe nenin 43 dhe 44 të RRUOPP-së, te ankesa me nr. 1115/20.
- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 parag.1, nenin 7 parag. 1, 2, 3, 4, 6, nenin 59 parag. 4, nenin 60 parag.1, 2 dhe nenin 62 parag.1, 2 të LPP-së, te ankesa me nr. 1160/20.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 21.12.2020 ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 11.01.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "PBC" SH.P.K-Prishtinë

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE ankues

Eksperti shqyrtues teknik pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë, specifikacionit teknik, përshkrimi i çmimeve, vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve të kësaj ekspertize mendon që AK ka vepruar në kundërshtim me nenet 59, 62 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE PBC SH.P.K:

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimet ankimor të OE "PBC" SH.P.K. – Prishtine lidhur me anulimin e ofertës së tyre dhe anulimin e aktivitetit te prokurimit nga AK – MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM sqaron se AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 62 lidhur me anulimin e aktivitetit te prokurimit. AK dhe komisioni vlerësues nuk ka kryer ekzaminim, vlerësim të ofertave sipas LPP dhe në përputhje me nenin 1 dhe nenin 59 të LPP. Arsyet e anulimit të aktivitetit të prokurimit nuk janë të bazuara dhe janë në kundërshtim me LPP. Andaj pretendimet ankimore të OE PBC SHPK janë të bazuara.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues N.T.SH "Unisoft" Arianit Bytyqi B.I-Prishtinë

Eksperti shqyrtues teknik lidhur me pretendimet ankimor të OE NTSH UNISOFT – Prishtine lidhur me anulimin e ofertës së tyre dhe anulimin e aktivitetit te prokurimit nga AK – MINISTRIA PËR KOMUNITET DHE KTHIM sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit. AK dhe komisioni vlerësues nuk ka kryer ekzaminim, vlerësim të ofertave sipas LPP dhe në përputhje me nenin 1 dhe nenin 59 të LPP. Arsyet e anulimit të aktivitetit të prokurimit nuk janë të bazuara dhe janë në kundërshtim me LPP. Andaj pretendimet ankimore të OE NTSH UNISOFT janë të bazuara. Eksperti shqyrtues teknik sqaron që AK dhe komisioni i vlerësimit gjatë procedurës së rivlerësimit duhet të kryejnë vlerësim profesional duke respektuar nenet 1, 7, 59, 62 të LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues-teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim për këtë aktivitet të prokurimit.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë 25.01.2021 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me datë 27.01.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 05.02.2021, te mbajtur nëpërmjet platformës elektronike ZOOM në ora 11:00, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesit e OE-ve ankuese, përfaqësuesit AK-së, eksperti shqyrtues nuk ka qen prezent ne seancë, ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, ankesat e operatorëve ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Kryetari i panelit hapi seancën e shqyrtimit kryesorë të ankesës

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me përbërjen e panelit, dhe pasi konstatoi se nga të pranishmit nuk pati vërejtje në këtë përbërje, vazhdoi me seancën.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit të OE-së se parë ankues z. Hamiti i cili deklaroj : ne mbesim ne tersi pran ankesës se parashtruar ne OSHP konsiderojmë se AK ka shkelur dispozitat e ligjit te prokurimit publik përkatësisht nenin 62 parag 1 piken 1.1 1.2 dhe 1.3 i cili ne merr specifike përcakton se kur nje aktivitet in prokurimit mund te përfundohet po ashtu konsiderojmë se AK ka shkelur nenin 44 te RRUOPP-së i cili po ashtu përcakton se kur mund dhe duhet te përfundohet një aktivitet i prokurimit , arsyet e dhëna nga AK ne vendimin e datës 04.12.2020 nuk cek arsye për te cilat mund te përfundohet një aktivitet i prokurimit prandaj konsiderojmë se nëse konsiderohen arsyet e dhëna nga AK dhe baza ligjore kur mund te përfundohet një aktivitet i prokurimit mund konstatohet lehtë se AK ka vepruar kundërligjshëm, po ashtu duam te theksojmë se PBC SHPK ehte i përgjegjshëm dhe ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit sa i përket konstatimit te ekspertit ne lidhje ma atë se aktiviteti i prokurimit është anuluar ne menyr te kundërligjshme bazuar ne nenin 62 te ligjit te prokurimit publik ne pajtohemi.

Propozoj qe ankesa e PBC SHPK te aprovohet si e bazuar dhe te obligoj AK qe te vazhdoj me procedurat e prokurimit bazuar ne ligj dhe ne dosjen e tenderit .

Nese me lejohet pe rate qe perëndi OE e dyte se PBC Shpk nuk i plotëson kerkessat e dosjes se tenderit ne fakt PBC shpk i plotëson te gjitha kerkesat e dosjes sse tenderit dhe kjo mund te vërtetohet lehtësisht nga deshmit e ofruara nga PBC .

Ne vazhdim fjalën ia dha përfaqësuesit te OE se dyte ankuese i cili deklaroj: se me datën 23.12.2020 ne kemi paraqitur pran OSHP-së ankesë lidhur me procedure e "Krijimi I bazës qendrore se te dhënave për regjistrimin e personave te zhvendosur dhe te kthyerve" te cilën e ka prokuruar MKK ne pretendojmë qe AK ne menyr te kundërligjshme e ka anuluar këtë aktivitet te prokurimit duke shkelur procedurat e nenet i ligjit te prokurimit

, njëkohësisht arsyet te cilat janë ne letrën standarde te eliminimit janë arsye te cilat nuk qëndron dhe janë te pa bazuara ne si kompani dhe si OE ankues me datën sot kemi kontaktuar me OSHP dhe kemi pranua sot ekspertizën deri me datën e sodit nuk kemi pasur ekspertizë ne pajtohemi me ekspertizën qe lënda te kthehet ne rivlerësim ne jemi OE i radhitur ne bazë te çmimit si OE i treti por pas qasjes ne dokmuntacionin te ofertës dhe ne qasje te tenderuesve te cilat janë me te lire inovative dhe PBS SHPK ne kemi vrejtur se ko oferta me realisht janë te pa përgjegjshme oferta e OE inovative dhe PBC SHPK nuk janë te me specifikime teknike te detyrushm e për shkak se kanë mangësi e specifikacionit teknik nuk kanë dorëzuar diagramin për procedurat dhe për ato te cilat janë kërkua rne specifikacione teknike . ne ankesin 1 te specifikacionit teknik i detyrueshëm thuhet se kompania duhet te ofroij zgjidhje teknike për çdo pike te përshkruar ne kërkesa teknike zgjidhja duhet te jetë ne formë te diagrames me përshkrim te detajuar , ne si kompani qe kemi ofertuar me ketë projekt kemi dorëzuar 13 diagrame për secilin pike veç e veç .

Na specifikacioni teknik tre detyrueshëm sipas aneksit 1 dmth OE te cilët janë me te lire me çmimi për nga oferta se oferta jon ju mungon diagrami për procesin aplikimit për asistenc , diagrami i procesit për printim dhe ngarkim te SMDH-së procesi per kriteret dhe prioritetet, moduli për regjistrimin e ankesës procesi i ztt dmth krejt kto ja diagrame te cilat janë te kërkuara ne specifikacionin teknik dhe ne baze te specifikacionit teknik nga AK dhe teremave te references eshte kerku qe secila zgjidhje te jet e ofruar me diagram pos shkrimeve dhe tekstit duhet te jet edhe e dokumentuar zgjidhja teknike me diagram e cila tregon zgjidhjen e secilës pjes ne si OE ikemi dorzuar edhe dokumentacionin sopecifikacionin teknik me shkrim edhe me tekst te cilin e kemi përcaktuar se si do te jet zgjidhja njëkohësisht ne dokument shtesë i kemi dërguar diagramet për secilën zgjidhje teknike për 13 pikat qe kërkohen. Pos kësaj kemi dërguar edhe diagramin e bazës se te dhënave qe siç palnifikojm na se duhet te jetë zgjidhja te jetë diagrami ne bazë te te dhënave me te gjitha tabelat perverse te saj ne baze te kërkesave te cilat jan nga AK dhe ne baze te kërkesave te cilat janë nga termet e referencës te cilat kanë qen pjesë perverse e dokumentacionit te dosjes se tenderit.

Ne kërkojmë nga OSHP qe lënda te kthehet ne rivlerësim ankesa jon te jetë e bazuar dhe ne pretendojmë se jemi oferta e përgjegjshme me çmimin me te lirë.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-së, i cili deklaroj: ne si AK MKK kemi ba vlerësime e krahasime ne mënyrën e vlerësimit te këtyre ofertave për bazën qendrore te te dhënave si dhe e ceken edhe OE anulimi i këtij projekti ka ardh si rezultat për shkak se kemi qen ne fundin e vitit fiskal si dhe aty ka qen një kriter qe plani dinamik i cili është kërkuar nga njësia kerkuse ka qen minimum 60 dite OE e din këtë mirëpo gjatë procedurës se prokurimit kemi pas opinion nga agjensioni anti korrupsion kemi pas kërkesa për rishqyrtim te ofertave te cilat ka qen dashur te ne momentin qe te vjen nje kerkes e till te vazhdohet afati edhe për 10 dite tjera kështu qe kena pas edhe gjatë vlerësimi na kanë marr kohë ofertat dhe vlerësimi i tyre dhe ne si AK kur e kemi llogaritur te gjitha keto edhe ka qen fundi i vitit kemi hyr brenda afatit te cilin është parapa si kriter

minimum për 60 dite OE ti kryej këto detyra dhe nuk kemi pas mundësi qe brenda këtyre ditëve te kryhet ky projekt dhe te behet pagesa OE nuk kemi pas mundësi mjetet kanë qen te vitit te kaluar për këtë vit nuk kanë qen te bartura kështu qe si AK ne nuk kemi dashur qe te marrim përgjegjësi dhe obligime ndaj buxhetit te Republikës se Kosoves dhe te hyjmë ne obligime për ekzekutimin e këtyre kontratave ne rast te tillë. Kështu qe kemi vendosur qe ky aktivitet i prokurimit edhe pse kemi pasur OE me te lire ne këtë rast qe është OE e kemi anulua dhe kemi marr vendim për anulimin e këtij aktivitetit qe te mos kemi obligime dhe te jemi pergjejgjes para ligjit për një projekt te till dhe kemi dhe e kmi fut ne projekt qe këtë vit do ta ritenderojm po te njëjtin projekt ne i kemi versuar OE e dhe oferta PBC ka qen me i lire me kriteret te cilat i tha edhe vet aty mirëpo i gjithë problemi ka qen fundi i vitit fiskal dhe nuk kemi mundur mi krye obligimet ndaj OE dhe nuk kemi guxu qe te hyjm ne obligime kur e dimë qe ligji thotë se pa i pas parat ne gjep nuk mundesh me ba ni kontratë te tillë njetet i kemi pas te zotime por afati për pagës ka qen data2 6.12.2020 ora 12 .
Ne si AK me mirëkuptimin edhe te OE edhe te panelit shqyrtues i propozojm pasi qe kjo kontrat ose ky projekt ka me vazhdua edhe këtë vit dhe do te zotohen mjetet tashe ne fillim ne do ta ritenderojm këtë projekt kështu qe OE te njëjtit do ta kenë mundësin qe te aplikojnë te konkurojn dhe te zgjidhet OE dhe te vzhdojm me procedura.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "PBC" SH.P.K-Prishtinë, se AK e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë, specifikacionit teknik, përshkrimi i çmimeve, vendimeve të AK dhe kërkesave për sqarime, sqaron se pretendimi ankimor është i bazuar dhe AK gjatë vlerësimit dhe ekzaminimit nuk ka vepruar konform nenit 59 të LPP-së, si dhe me rastin e anulimit të këtij aktivitetit të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së sepse arsyeja e anulimit se AK nuk ka mjete nuk qëndron, pasi që vet AK e ka planifikuar këtë aktivitet të prokurimit në vitin 2021.

Lidhur me pretendimin e OE ankues N.T.SH "Unisoft" Arianit Bytyqi B.I-Prishtinë, që ka të bëjë me anulimin e ofertës së tyre dhe anulimin e aktivitetit te prokurimit nga AK, Paneli Shqyrtues sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 lidhur me anulimin e aktivitetit të prokurimit. Arsyetimi i AK-së se nuk ka mjete financiare për këtë aktivitet të prokurimit nuk qëndron sepse AK në buxhetin e vitit 2021 e ka paraparë këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se AK nuk ka kryer ekzaminim dhe vlerësim të ofertave sipas LPP dhe në përputhje me nenin 1 dhe nenin 59 të LPP.

Sa i përket pretendimit të OE ankues N.T.SH "Unisoft" Arianit Bytyqi B.I-Prishtinë, kundrejt tenderit të OE "PBC" SH.P.K-Prishtinë, se nuk ka dorëzuar diagramet siç janë kërkuar në specifika teknike, Paneli Shqyrtues

sqaron se ky pretendim ankimor i OE ankues është i bazuar pasi që OE "PBC" SH.P.K-Prishtinë nuk i ka dorëzuar diagramet ashtu siç i ka kërkuar AK tek specifikimet teknike. Andaj, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve dhe analizës konkrete, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues me rastin e ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së, si dhe AK me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka vepruar në kudnërshtim me nenin 62 të LPP-së. Po ashtu, Paneli Shqyrtues sqaron se arsyetimi i autoritetit kontraktues se nuk posedon mjete financiare për këtë aktivitet të prokurimit është arsyetim i pa bazuar sepse AK ne buxhetin e vitit 2021 e ka planifikuar këtë aktivitet të prokurimit dhe kjo arsye e anulimit është e pa bazuar. Andaj, obligohet AK që të bëjë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe duke u bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Nuhi PAÇARIZI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Ministria për Komunitet dhe Kthim";

1x1 OE "PBC" SH.P.K-Prishtinë;

1x1 OE N.T.SH "Unisoft" Arianit Bytyqi B.I-Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.